

**VENDIM**  
**Nr. 772, datë 15.12.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO NDËRHJRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në pikën 2.2, të vendimit nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shifra “... 1 375 821 704 (një miliard e treqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e katër) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 1 538 821 704 (një miliard e pesëqind e tridhjetë e tetë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e katër) lekë pa TVSH ...”.

b) Në shkronjën “a”, shifra “... 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë pa TVSH ...” zëvendësohet me “... 663 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë) lekë pa TVSH ...”.

2. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**